



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

Nr. Prot. 1073 Dt. 26.05.2021

RREGULLORE PUNE

Këshilli Botues i Universitetit "Isa Boletini" – Mitrovicë

Mitrovicë, 2021

Rr. Ukshin Kovaçica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
<http://www.umib.net>; info@umib.net; Tel: +383-28/535725/515516 – lokali 1



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

Në bazë të Nenit 4, parag. 4.5, të Rregullores për botime në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini", Nr. 1310, datë 05.10.2020, Këshilli Botues në mbledhjen e mbajtur me 11.05.2021, miratoi

RREGULLOREN E PUNËS

të Këshillit Botues të Universitetit "Isa Boletini" – Mitrovicë

I. DISPOZITAT E PERGJITHSHME

1. Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e punës së Këshillit Botues të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë (thirrja e mbledhjes, mbajtja, mënyra e vendosjes dhe zbatimi i vendimeve si dhe çështjet tjera përkatëse).
2. Çdo anëtar i Këshillit Botues është i obliguar që të veprojë në pajtim me rregullat e kësaj Rregulloreje. Me fillimin e punës në Këshillin Botues, anëtari merr përsipër obligimet e punës të përcaktuara me këtë Rregullore.
3. Te qenit anëtar i Këshillit Botues nuk është në kundërshtim me asnjë mandat tjetër në Universitet.

II. PERBËRJA, MANDATI DHE PERGJEGJËSIA E ANËTARËVE TË KËSHILLIT BOTUES

1. Këshilli Botues përbëhet nga një anëtar për njësi akademike me te drejtë vote. Prorektori për mësimdhënie dhe çështjet e studenteve ose prorektori për bashkëpunim ndërkombëtar dhe kërkime shkencore sipas detyrës zyrtare, me te drejte vote.
2. Mandati i anëtarëve të Këshillit Botues është katër vite.
3. Anëtari i Këshillit Botues duhet t'i kryejë punët me profesionalizëm, korrektësi, me kohë dhe përgjegjësi.



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

III. KRYESUESI I KËSHILLIT BOTUES

1. Mbledhjen konstitutive të Këshillit Botues e thërret njëri nga prorektorët e UIBM, i cili e kryeson atë vetëm derisa të zgjedhet kryesuesi i Këshillit Botues.
2. Kryesuesi i Këshillit Botues zgjedhet nga anëtarët e Këshillit Botues në mbledhjen konstituive të këtij Këshilli.

IV. MBLEDHJET E KËSHILLIT BOTUES

1. Këshilli Botues është i obliguar të mbledhet së paku dy here në vit. Njëherë në fillim të semestrit dimëror dhe njëherë në fillim të semestrit veror. Por, kryesuesi i Këshillit Botues i thërret mbledhjet edhe sipas nevojës.
2. Mbledhjet thirren në afat kohor prej së paku tri ditë para takimit. Ftesat mund të bëhen me shkrim, me email ose në çfarëdo forme tjetër teknike, me të cilin dërgesa dhe informimi janë të sigurt.
3. Mbledhjet e jashtëzakonshme mund të mbahen në çfarëdo kohe sipas procedurave të parapara. Rendi i ditës për këto mbledhje është i kufizuar në një pikë kryesore. Në raste të jashtëzakonshme, kur kërkohen veprime urgjente, ftesat mund të dërgohen në afat edhe më të shkurt se tri ditë.
4. Mbledhjet i thërret dhe i kryeson kryesuesi i Këshillit.
5. Në mbledhjet e Këshillit mund të vendoset për thirrjen e ndonjë mbledhje të ardhshme të Këshillit. Në këto raste anëtarët e Këshillit që nuk janë të pranishëm ftohen posaçërisht.
6. Secili anëtar është i detyruar të konfirmojë pjesëmarrjen nëpërmes email-it zyrtar të Universitetit.

V. PJESËMARRJA NË MBLEDHJE

1. Te gjithë anëtarët e Këshillit Botues kanë të drejt dhe janë të obliguar të marrin pjesë në mbledhjen e Këshillit Botues.
2. Nëse anëtari i Këshillit nuk mund të marrë pjesë në mbledhje për shkaqe të arsyeshme, duhet ta njoftojë me kohë kryesuesin.
3. Nëse anëtari i Këshillit dy herë radhazi nuk merr pjesë në mbledhje pa arsyetim, Këshilli është i detyruar të iniciojë largimin/zëvendësimin e tij/saj.



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË**

4. Kryesuesi ka të drejtë të ftojë në mbledhje edhe persona tjerë apo të komunikojë me ta me shkrim: redaktor, lektor, recensionist, korigjues etj.
5. Kryesuesi i Parlamentit të Studentëve mund të merr pjesë në mbledhjet e Këshillit Botues por pa të drejt vote.

VI. ORGANIZIMI I MBLEDHJES

1. Mbledhjet e Këshillit Botues janë të hapura për publikun.
2. Mbledhjen e hap, fillon, kryeson, ndërpret dhe përfundon kryesuesi i Këshillit Botues. Në rast të mungesës së kryesuesit, mbledhjen e kryeson zëvendës kryesuesi. Nëse kryesuesi dhe zëvendës kryesuesi nuk mund të marrin pjesë në mbledhje, mbledhjen e Këshillit Botues e kryeson anëtari më i vjetër i Këshillit Botues.
3. Para se të fillojë mbledhja e Këshillit Botues, anëtarët e Këshillit Botues do të nënshkruhen në listën e pjesëmarrjes e cila është pjesë integrale e procesverbalit.
4. Në fillim të mbledhjes kryesuesi konstaton nëse janë të pranishëm shumica e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit Botues.
5. Rendi i ditës duhet të caktohet nga kryesuesi i Këshillit dhe për këtë duhet të informohen anëtarët e Këshillit së paku tri ditë para mbledhjes.
6. Anëtarët e Këshillit Botues kanë të drejtë të propozojnë ndryshimin dhe plotësimin e rendit të ditës, duke i arsyetuar propozimet.
7. Miratimi i rendit të ditës aprovohet me shumicë votash të anëtarëve të Këshillit Botues.

VII. ECURIA E MBLEDHJES

1. Pas miratimit të rendit të ditës kalohet në aprovimin e procesverbalit të mbledhjes paraprake.
2. Anëtarët e Këshillit kanë të drejtë që të paraqesin vërejtje në procesverbal dhe të kërkojnë që të bëhen ndryshime, ose plotësime. Për themelësinë e vërejtjeve në procesverbal vendoset me shumicë votash të anëtarëve të Këshillit Botues.
3. Më tutje shqyrtohen çështjet e propozuara për diskutim në kuadër të pikave të rendit të ditës.
4. Raportin dhe arsyetimin rreth secilës pikë të rendit të ditës e paraqet kryesuesi ose personi i caktuar nga kryesuesi, pas të cilit kryesuesi e hap diskutimin.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË

5. Kryesuesi e jep fjalën sipas radhës së paraqitjes për diskutim. Në mbledhjen e Këshillit Botues nuk mund të diskutoj asnjëri nga anëtarët pa e lejuar fjalën kryesuesi i mbledhjes.
6. Anëtarët duhet të praktikojnë shprehi të mira gjatë mbajtjes së mbledhjes.
7. Çdo mosrespektim i dispozitave të kësaj Rregulloreje do të konsiderohet si shkelje e rregullave të punës, dhe do të jetë arsye për iniciimin e procedurës së përjashtimit nga Këshilli.
8. Kryesuesi është përgjegjës për respektimin e Rregullores së Punës së këtij Këshilli për veprimet dhe sjelljet e anëtarëve të këtij Këshilli.
9. Kryesuesi ka të drejtë të kërkojë nga folësit që t'i përmbahen temës.
10. Për çdo pikë të rendit të ditës pjesëmarrësit kanë të drejtë të diskutojnë më së shumti dy here.
11. Kryesuesi ka të drejtë të ndërpresë mbledhjen e këshillit më së shumti 20 minuta. Gjithashtu ka të drejtë ta ndërpresë mbledhjen, nëse mbledhja nuk mund të përfundojë brenda ditës.
12. Kryesuesi ka të drejtë ta përmbyll para kohe mbledhjen, nëse ai konstaton se nuk ka kushte normale për vazhdimin e saj kur nuk mund ta vejë rendin dhe nuk ka mjete tjera të rregullta.

VIII. PARASHTRIMI I PROPOZIMEVE DHE KUNDËRSHTIMEVE

1. Secili anëtarë i Këshillit Botues jep ide, mendime dhe pikëpamje për politikën dhe për avancimin e publikimeve universitare.
2. Anëtari i Këshillit Botues ka të drejtë të parashtojë propozim për çështjet e ndryshme që kanë të bëjnë me botimin e publikimeve universitare të UIBM, e gjithashtu edhe të shpreh pakënaqësinë e tij nëse nuk pajtohet me një çështje të shtruar për diskutim.
3. Materialet e shkresave (propozimeve dhe kundërshtimeve), të cilat bashkëngjiten gjatë mbledhjes, mund të miratohen me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve me të drejtë vote.

IX. VENDOSJA, VOTIMI DHE PROCEDURA E VOTIMIT

1. Pas shqyrtimit dhe përfundimit të diskutimeve, sipas rendit të ditës, Këshilli Botues merr vendim apo konkluzion.
2. Këshilli vendos me shumicë të votave nga të gjithë anëtarët e Këshillit. Në rast se numri i votave është i barabartë, vota e kryetarit është vendimtare.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË

3. Kuorumi (shumica e përgjithshme) është i nevojshëm për fillimin e seancës, miratimin e rendit të ditës, miratimin e procesverbalit dhe për propozimet dhe vendimmarrjet e Këshillit Botues. Për këtë kriter kryesuesi i njofton anëtarët e Këshillit.
4. Nëse ka shumë propozime të vendimeve dhe konkluzioneve, së pari votohet për ato të përfshira në material ose me propozimin e kryesuesit, pastaj për propozimet e tjera.
5. Para se të votohet, kryesuesi e formulon propozimin e vendimit ose të kërkesës lidhur me çështjen që vendoset.
6. Anëtarët e Këshillit Botues votojnë personalisht dhe nuk lejohet delegimi i votës.
7. Votimi në mbledhje të Këshillit Botues bëhet me aklamacion (me ngritje të dorës) ose me votim të fshehtë. Për mënyrën e votimit, Këshilli vendosë në mbledhjen përkatëse.
8. Anëtari i Këshillit voton duke deklaruar “për”, “kundër” ose “abstenon”.
9. Pas votimit, në bazë të rezultateve të votimit, kryesuesi konstaton se propozimi i vendimit ose kërkesa tjetër është miratuar apo refuzuar.
10. Kryesuesi i Këshillit Botues i ofron anëtarëve të Këshillit mundësinë për komente dhe vërejtje eventuale në procesverbal, brenda dy jave nga data e dërgimit.

X. PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA

1. Në çdo mbledhje të Këshillit Botues mbahet procesverbal. Procesverbalin e nënshkruajnë kryesuesi dhe procesmbajtësi.
2. Procesverballi duhet të përmbajë këto elemente: vendin, datën dhe kohën e fillimit dhe të mbarimit të mbledhjes, rendin e ditës, listën e pjesëmarrësve dhe të atyre që mungojnë, të gjitha propozimet dhe rezultatet e votimeve përkatëse, shënimet thelbësore mbi rrjedhën e mbledhjes. Lista me nënshkrime të pjesëmarrësve duhet t’i bashkëngjitet procesverbalit.
3. Procesverballi duhet të përgatitet brenda tri ditëve pas mbledhjes së Këshillit dhe si ekstrakt tu dërgohet anëtarëve të Këshillit. Nga anëtarët e Këshillit Botues kërkohet që në afat prej dy jave (nga data e dërgimit) të japin komente apo vërejtje eventuale për procesverbal.
4. Në rast se komentet janë të bazuara, atëherë Kryesuesi thërret mbledhje të jashtëzakonshme.
5. Procesverballi miratohet në mbledhjen e radhës së Këshillit (në qoftë se nuk ka pasur komente apo vërejtje të bazuara në afatin kohor prej dy jave).

XI. PUNA E KOMISIONIT PËR NDRYSHIMIN, PLOTËSIMIN E KËSAJ RREGULLOREJE



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

1. Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj Rregulloreje bëhet sipas procedurës së njejtë me atë të miratimit të saj.
2. Rregullorja hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Këshilli Botues.

XII. AKTET E KËSHILLIT BOTUES

1. Rregulloren e Punës së Këshillit Botues e nxjerr dhe e miraton vet Këshilli Botues
2. Këshilli Botues nxjerr edhe Rregulloren e Botimeve, vendime, konkluzione dhe propozime drejtuar Senatit.

XIII. DISPOZITAT KALIMTARE

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Këshillit Botues.



Kryesuesi i Këshillit Botues të UIBM